

ARC sh.p.k.
Pasqyrat Financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
OPINIONI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
PASQYRA E PERFORMANCËS	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	6
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	7-20

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Për Menaxhimin dhe ortakun e vetëm të Shoqërisë ARC sh.p.k.

Opinion

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Shoqërisë **ARC sh.p.k** (Shoqëria) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datën 31 dhjetor 2017, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2017, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Çështje të tjera

Pasqyrat financiare të **ARC sh.p.k** për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016, kanë qenë audituar nga një auditues tjetër, i cili ka shprehur një opinion të pakualifikuar me datë 31 mars 2017.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SKK, dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së Shoqërisë për të vazhduar aktivitetin e saj në bazë të parimit të vijimësisë, shënimet shpjeguese, si edhe për çështjet që lidhen me vazhdimësinë e aktivitetit të shoqërisë, duke përdorur parimet bazë të vazhdimësisë, përveç rastit kur drejtimi ka për qëllim të likuadojë aktivitetin, ose të ndërpresë aktivitetin operacional, ose nuk ka asnjë alternativë tjetër reale përveçse më lart.

Palët e ngarkuara me qeverisjen janë përgjegjëse për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare


Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të marra bazuar në këto pasqyra financiare.


Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional gjatë gjithë periudhës së auditimit. Gjithashtu ne:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë rrezikun e anomalive materiale në pasqyrat financiare, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve, planifikojmë dhe zbatojmë procedurat përkatëse për zbutjen e këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidencë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të krijuar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e mashtrimit është më i lartë se rreziku i moszbulimit të një anomalie si pasojë e gabimit, për shkak se, mashtrimi mund të përfshijë fshehje të informacionit, falsifikim të informacionit, përvetësime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Marrim një kuptueshmëri të atyre kontrolleve të brendshme relevante për procesin e auditimit me qëllim hartimin e procedurave të auditimit në përputhje me rrethanat, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël të kryera si edhe paraqitjen në shënimet shpjeguese përkatëse të bëra nga Drejtimi.
- Shprehemi në lidhje me përshtatshmërinë e parimit të vijimësisë, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, mbi ekzistencën e një pasigurie materiale mbi aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi aktivitetin e saj. Nëse një pasiguri materiale ekziston, ne duhet të tërheqim vëmendjen në shënimin shpjegues përkatës, nëpërmjet raportit tonë të auditimit, ose nëse shënimet shpjeguese nuk janë të përshtatshme ne duhet të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona jepen mbi bazën e evidencës së auditimit të marrë deri më datën e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet në të ardhmen mund të shkaktojnë ndërprerje të aftësisë së Shoqërisë për vijimësi.
- Vlerësojmë paraqitjen, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare dhe të shënimeve shpjeguese dhe në rast se ato përfaqësojnë drejt transaksionet dhe ngjarjet.

Ne komunikojmë me personat të ngarkuar për qeverisjen e Shoqërisë, përveçse çështjeve të tjera, edhe objektin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet kryesore të auditimit, përfshirë çdo mangësi relevante në kontrollin e brendshëm të identifikuar gjatë auditimit tonë.

13 qershor 2018


Teit Gjini
Auditues Ligjor


Rr. Emin Duraku, Pall. "Brijdesht",
No.5, 1000, Tirana, Albania
Phone: +355 42 27 80 15
www.mazars.al, info@mazars.al

Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2017

	Shënime	31 dhjetor 2017	31 dhjetor 2016
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	47,080,037	62,162,334
Huadhënie afatshkurtër	5	59,893,975	31,373,360
Llogari të arkëtueshme tregtare	6	2,131,795	1,414,148
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	7	16,692,920	37,053,722
Të arkëtueshme të tjera	8	8,044,614	106,940
Kapitali i nënshkruar dhe i papaguar	9	-	100,000
Totali i aktiveve afatshkurtra		133,843,341	132,210,504
Aktivet afatgjata			
Investime financiare	10	22,798,050	-
Aktive afatgjata materiale	11	76,196,559	57,440,868
Totali i aktiveve afatgjata		98,994,609	57,440,868
Totali i aktiveve		232,837,950	189,651,372
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	12	9,920,010	8,772,647
Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare	17	6,295,488	-
Detyrime tatimore	13	2,238,999	20,970,256
Garanci të marra	14	304,566	-
Detyrime ndaj palëve të lidhura	15	18,613	52,100,753
Të tjera detyrime	16	7,892	-
Totali i detyrimeve afatshkurtra		18,785,568	81,843,656
Detyrime afatgjata			
Qira financiare	17	18,146,472	-
Totali i detyrimeve afatgjata		18,146,472	-
Totali i detyrimeve		36,932,040	81,843,656
Kapitali			
Kapitali i nënshkruar		100,000	100,000
Fitim (humbje)/ të mbartura		107,707,716	(21,557,991)
Fitimi i ushtrimit		88,098,194	129,265,707
Totali i kapitalit	18	195,905,910	107,807,716
Totali i kapitalit dhe detyrimeve		232,837,950	189,651,372

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016	
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	19	236,689,567	338,436,480
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	20	(1,229,402)	96,201
Lënda e parë, materiale të konsumueshme dhe të tjera shpenzime		(97,588,514)	(150,265,559)
1) Lënda e parë, materiale të konsumueshme	21	(94,922,098)	(148,963,182)
2) Të tjera shpenzime	22	(2,666,416)	(1,302,377)
Shpenzime të personelit	23	(18,582,722)	(28,470,197)
1) Paga dhe shpërblime		(16,931,672)	(26,959,496)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetësore		(1,651,050)	(1,510,701)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	24	(14,174,560)	(5,248,490)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	25	(12,555)	(274,561)
Shpenzime financiare	26	(1,323,931)	(2,148,120)
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		(837,385)	-
2) Shpenzime të tjera financiare		(486,546)	(2,148,120)
Fitimi/humbja para tatimit		103,777,883	152,125,754
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	27	(15,679,689)	(22,860,047)
1) Shpenzimi aktual i tatimit mbi fitimin		(15,679,689)	(22,860,047)
2) Shpenzimi aktual i tatimit të shtyrë		-	-
Fitimi/humbja e vitit		88,098,194	129,265,707
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse për vitin		88,098,194	129,265,707

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

ARC sh.p.k

(Vlerat janë në Lek)

**Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017**

	Kapitali i nënshkruar	Fitimet e Pashpërdara	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2016	100,000	(21,557,991)	-	(21,457,991)
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				
Fitimi / Humbja e vitit			129,265,707	129,265,707
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2016	100,000	(21,557,991)	129,265,707	107,807,716
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				
Transferimi i fitimit të mbartur		129,265,707	(129,265,707)	-
Fitimi / Humbja e vitit			88,098,194	88,098,194
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2017	100,000	107,707,716	88,098,194	195,905,910

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 janë aprovuar nga administratori i ARC sh.pk më _____ dhe janë firmosur si më poshtë.

Zenel Hysenbegasi
Zenel Hysenbegasi
 Administrator



Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	88,098,194	129,265,707
<i>Rregullimet për shpenzimet jomonetare:</i>		
Shpenzimet financiare jomonetare		
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	14,174,560	5,248,490
Fitim nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	24,075	
<i>Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet e shfrytëzimit:</i>		
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	11,598,541	(3,408,008)
Huadhënie afatshkurtër	(28,413,675)	(31,290,027)
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	(69,658,142)	6,781,892
Rritje/(rënie) në garanci të marra	304,566	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	16,128,119	106,598,054
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Para neto të përdorura për blerjen e filialeve	(22,798,050)	-
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(40,275,595)	(58,179,211)
Arkëtime nga shitja e aktiveve afatgjata materiale	7,321,269	4,419,946
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(55,752,376)	(53,759,265)
Fluksi i Mjeteve Monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Arkëtime nga emetimi i kapitalit aksionar	100,000	
Pagesa e huave	24,441,960	-
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	24,541,960	-
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	(15,082,297)	52,838,789
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	62,162,334	9,323,545
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 31 dhjetor	47,080,037	62,162,334

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 7 deri në 20, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

ARC sh.p.k është themeluar si një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me NUIS K81728025F, në përputhje me ligjin 9901 datë 19.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe nga statuti i saj.

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është shërbime logjistike, organizim i udhëtimeve individuale dhe kolektive për stafe profesionale, rezervime, shërbime guide. Masterplane-studime rajonale dhe urbanistike. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë është 100,000 Lek dhe zotërohet nga ortaku i vetëm Z. Besnik Leskaj.

Zyra qendrore e Shoqërisë ndodhet në rrugën "Themistokli Gërmenji", Pallati përballë RTSH, Kati 1.

Në 31 dhjetor 2017 shoqëria ka 15 punonjës. (2016: 10 punonjës)

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)**2.5. Vlerësime dhe gjykime (vazhdim)****2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme**

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitetet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmben në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2017 dhe 2016 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2017	2016
Euro/LEK	132.95	135.23
USD/ LEK	111.10	128.17

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare çregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare çregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali

Kapitali njihet me vlerën nominale.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.2. Instrumentat financiare (vazhdim)***Zhvlerësimi i aktiveve financiare*

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Aktive afatgjata materiale*i. Njohja dhe matja*

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendjen e mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2017 dhe 2016 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Pajisje zyre dhe informatike	Vlera e mbetur	25 %
Mobilje zyre	Vlera e mbetur	20 %
Mjete Transporti	Vlera e mbetur	20 %

3. Politikat Kontabël (vazhdim)**3.4. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***iv. Çregjistrimi*

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëhere kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit. Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen në të ardhura ose shpenzime në mënyrë lineare gjatë afatit të qirasë.

Shoqëria ka qira operative dhe financiare.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2017 është 15% (2016: 15%).

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.9. Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore. Shoqëria nuk ka burim diferencash të përkohshme për njohjen e tatimi të shtyrë.

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributesh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Mjete monetare në bankë	46,782,867	62,150,282
Në lekë	2,479,349	3,175,995
Në monedhë të huaj	44,303,518	58,974,287
Mjete monetare në arkë në lekë	297,170	12,052
	<u>47,080,037</u>	<u>62,162,334</u>

5. Huadhënie afatshkurtër

Huadhënia afatshkurtër më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqitet si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Huadhënie M&P	30,844,400	31,373,360
Huadhënie Albrail	22,402,075	-
Huadhënie ndaj ortakut	6,647,500	-
	<u>59,893,975</u>	<u>31,373,360</u>

6. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Klientë	2,131,795	1,414,148
	<u>2,131,795</u>	<u>1,414,148</u>

7. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Të arkëtueshme nga Abkons	15,868,804	36,984,755
Arta Gurabardhi	-	68,967
Të arkëtueshme nga Ikons	824,116	-
	<u>16,692,920</u>	<u>37,053,722</u>

8. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Tatim fitimi i arkëtueshëm	7,961,281	-
Garanci të dhëna	83,333	83,333
Të arkëtueshme të tjera	-	23,607
	<u>8,044,614</u>	<u>106,940</u>

9. Kapitali i nënshkruar dhe i papaguar

Kapitali i nënshkruar dhe i papaguar detajohet si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kapital i nënshkruar i papaguar	-	100,000
	<u>-</u>	<u>100,000</u>

10. Investime financiare

Investimet financiare detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Kuota në kompaninë Albrail (16.85%)	22,798,050	-
	<u>22,798,050</u>	<u>-</u>

11. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje dhe orendi	Pajisje informatike	Mjete transporti	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 1 janar 2016	8,679,563	422,034	3,968,075	13,069,672
Shtesa	13,000	43,333	58,122,878	58,179,211
Pakësime			(4,675,301)	(4,675,301)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	8,692,563	465,367	57,415,652	66,573,582
Shtesa	77,500	105,817	40,092,278	40,275,595
Pakësime			(9,002,918)	(9,002,918)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	8,770,063	571,184	88,505,012	97,846,259
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 1 janar 2016	3,968,172	171,387		4,139,559
Amortizimi i vitit	944,228	67,176	4,237,086	5,248,490
Pakësime			(255,335)	(255,335)
Gjendja më 31 dhjetor 2016	4,912,400	238,563	3,981,751	9,132,714
Amortizimi i vitit	765,074	70,797	13,338,689	14,174,560
Pakësime			(1,657,574)	(1,657,574)
Gjendja më 31 dhjetor 2017	5,677,474	309,360	15,662,866	21,649,700
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2016	3,780,163	226,804	53,433,901	57,440,868
Gjendja më 31 dhjetor 2017	3,092,589	261,824	72,842,146	76,196,559

12. Llogari të pagueshme tregtare

Llogari të pagueshme tregtare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Furnitorë në lekë	8,552,681	8,772,647
Furnitorë në monedhë	1,367,329	-
	<u>9,920,010</u>	<u>8,772,647</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Detyrime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	483,705	248,410
Detyrime për tatimin mbi të ardhurat personale	674,767	216,066
Tatim në burim	-	30,427
TVSH për t'u paguar	1,080,527	6,193,737
Tatim fitimi	-	14,281,616
	<u>2,238,999</u>	<u>20,970,256</u>

14. Garanci të marra

Garancitë e marra më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Garanci të marra	304,566	-
	<u>304,566</u>	<u>-</u>

15. Të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Të pagueshmet ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
ABKONS	18,613	
Besnik Leskaj	-	18,575,640
Arjan Leskaj	-	33,525,113
	<u>18,613</u>	<u>52,100,753</u>

ARC sh.p.k
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017
(Vlerat janë në Lek)

16. Të tjera detyrime

Të tjera detyrime më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Paga dhe shpërblime për punonjësit	7,892	-
	<u>7,892</u>	<u>-</u>

17. Qira financiare

Detyrimet për qira financiare më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Pjesa afatshkurtër e qirasë financiare	6,295,488	-
Pjesa afatgjatë e qirasë financiare	18,146,472	-
	<u>24,441,960</u>	<u>-</u>

18. Kapitali

Kapitali i nënshkruar nuk ka patur ndryshime dhe mbetet në total prej 100,000 lekë.

Fitim (humbjet) e mbartuara më 31 dhjetor 2017 është 107,707,716. (31 dhjetor 2016: (21,557,991)).

	<u>31 dhjetor 2017</u>	<u>31 dhjetor 2016</u>
Numri i përgjithshëm i kuotave	1	2
Vlera nominale	100,000	50,000
	<u>100,000</u>	<u>100,000</u>

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shërbimet e logjistikës	233,785,816	337,991,209
Të ardhura nga qiraja	2,903,751	445,271
	<u>236,689,567</u>	<u>338,436,480</u>

19. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit (vazhdim)

Rakordimi i të ardhurave me deklaratat e TVSH-së.

	<u>31 dhjetor 2017</u>
Qarkullim i tatueshëm	244,412,254
Zbriten garancitë paraqitur në detyrime	(304,566)
Zbriten të ardhura nga shitja e aktiveve (paraqitur neto)	(7,321,269)
Zbritet faturë për sistemim e TVSH për aktivin e shitur	(96,852)
Shuma e qarkullimit e korrektuar	236,689,567
Sipas Kontabilitetit	<u>236,689,567</u>
Diferenca	<u>-</u>

20. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë të ardhurat të tjera të realizuara gjatë aktivitetit të shfrytëzimit si dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar dhe detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shitja e aktiveve (neto)	-	96,201
Të ardhura nga kembimet valutore aktiviteti operativ (neto)	(1,229,402)	-
	<u>(1,229,402)</u>	<u>96,201</u>

21. Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme

Në këtë zë paraqiten kostoja e mallrave, lëndeve të para dhe shërbimeve të konsumuara.

Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shërbim logjistike	69,346,047	128,193,488
Shpenzime qiraje	6,300,313	7,397,602
Karburant	10,182,448	4,395,520
Sigurime	-	815,645
Shpenzime për makinat	7,636,519	1,572,518
Shpenzime të tjera direkte	1,456,771	6,588,409
	<u>94,922,098</u>	<u>148,963,182</u>

22. Të tjera shpenzime

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Personel jashtë njësisë	210,000	150,000
Rezultati neto nga shitja e aktiveve	24,075	-
Shërbime bankare	141,471	83,068
Taksa të ndryshme	134,000	128,416
Shpenzime të tjera	2,156,870	940,893
	<u>2,666,416</u>	<u>1,302,377</u>

Rezultati nga shitja e aktiveve afatgjata materiale:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Të ardhura nga shitja e AAM	7,321,269	4,323,194
Shpenzime nga shitja e AAM	(7,345,344)	(4,226,993)
	<u>(24,075)</u>	<u>96,201</u>

23. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për paga	16,931,672	26,959,496
Shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore	1,651,050	1,510,701
	<u>18,582,722</u>	<u>28,470,197</u>

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2017 është 15 (2016: 10).

24. Shpenzime konsumi dhe amortizimi

Shpenzimet e konsumit dhe amortizimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime amortizimi	14,174,560	5,248,490
	<u>14,174,560</u>	<u>5,248,490</u>

25. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Gjoha të ndryshme	12,555	274,561
	<u>12,555</u>	<u>274,561</u>

26. Shpenzime financiare (neto)

Shpenzimet financiare (neto) detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
Shpenzime për interesa	837,385	-
Humbje nga këmbimet valutote	486,546	2,148,120
	<u>1,323,931</u>	<u>2,148,120</u>

27. Shpenzime tatim fitimi

Shpenzimi për tatim fitimin detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016:

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2016</u>
<i>Fitimi para tatimit</i>	<u>103,777,883</u>	<u>152,125,754</u>
Total shpenzime të panjohura	753,376	274,561
Shpenzime udhëtimi		
Penalitete, gjoha e dëmshpërblime	12,555	274,561
Vlera kontabël e AAM të shitura	24,075	
Shpenzime të tjera	716,746	
<i>Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)</i>	<u>104,531,259</u>	<u>152,400,315</u>
Humbje fiskale e mbartur	-	-
<i>Tatim fitimi @15%</i>	15,679,689	22,860,047
	<u>88,098,194</u>	<u>129,265,707</u>

28. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Të arkëtueshme	Të pagueshme	Të arkëtueshme	Të pagueshme
Abkons	15,868,804	18,613	36,984,755	
Ikons	824,116			
Besnik Leskaj				18,575,640
Arta Gurabardhi			68,967	
Albanian Financial Institution		24,441,960		
Arjan Leskaj				33,525,113
	16,692,920	24,460,573	37,053,722	52,100,753

Transaksionet me palët e lidhura për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2017 dhe 31 dhjetor 2016 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2017		31 dhjetor 2016	
	Shitje	Blerje	Shitje	Blerje
ABKONS	234,230,027	139,983	380,570,535	21,859,954
Albanian Financial Institution	228,032	10,546,996		
Redjan Basha	3,084,022			210,416
Matrix Konstuksion		5,245,706		4,929,778
Arta Gurabardhi		349,844	69,182	946,871
Josif Gjani			1,104,354	
Besnik Leskaj		349,844		
	237,542,081	16,632,373	381,744,071	27,947,019

29. Angazhime dhe pasiguri*Çeshtje gjyqësore*

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të Shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Më 31 Dhjetor 2017 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të ketyre pasqyrave financiare.

Detyrimet tatimore

Librat e Shoqërisë nuk janë audituar nga organet tatimore për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2017. Si rrjedhojë detyrimet tatimore nuk mund të konsiderohen përfundimtare. Detyrime të mundshme që mund të rezultojnë nga një auditim i organeve tatimore nuk mund të maten në mënyrë të besueshme

30. Ngjarje pas datës së bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.